



Prof. dr. Lush Culaj
(Instituti Albanologjik Prishtinë)

Bio e shkurtër

Lush Culaj (1966), historian i kohëve moderne, është Këshilltar Shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Doktoroi më 2001, në fushë të historisë së shtetndërtimit shqiptar. Nga viti 1996 punon në Institutin Albanologjik. Gjatë viteve 2002-2013 ishte shef i Departamentit të Historisë dhe anëtar i Këshillit Drejtues; nga viti 2006 është anëtar i redaksisë në revistën shkencore “Gjurmime albanologjike” SSHH. Aktualisht është Kryeredaktor i kësaj reviste. Është angazhuar në studimet doktorale dhe në komisione për mbrojtjen e masterave dhe disertacioneve të doktoraturës në Prishtinë dhe Tiranë. Është bashkëautor në *Historinë e shqiptarëve*, të Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë (2022). Ka qenë i propozuar për anëtar të Akademisë të Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka shkruar zëra me rëndësi për *Fjalorin Enciklopedik të Shqipërisë* (AShSh) dhe për *Fjalorin Enciklopedik të Kosovës* (AShAK). Është autor i 15 librave studimorë dhe bashkautor i disa librave shkollorë.

Titulli: Relacioni mbi bandat e armatosura në Shqipëri, 1945–1948, sipas dokumenteve të Autoritetit të Dosjeve

Abstrakt

Në arkivën e Autoritetit të Dosjeve të komunizmit në Shqipëri gjendet edhe një relacion mbi të ashtuquajturat bandat e armatosura në Shqipëri. Sipas raportit “reaksioni” shpresonte të ndryshonte situata dhe ata do ta merrnin përsëri pushtetin në dorë. Emri i parë që përmendet në raport ishte i

Muharrem Bajraktarit, për të vazhduar me emrin e Mark Gjon Markut, Fiqri Dinos, Alush Leshanakut etj. Raporti nuk përmban të dhëna për bashkëpunimin e këtyre “bandave” me “bandat” dhe personalitetet nga Kosova por kur përmendët Muharrem Bajraktari nga relacione të tjera dokumentare e dimë bashkëpunimin e tyre me krerët nga Kosova përfshirë edhe profesor Ymer Berishën dhe Ndue Përllëshin. Sipas raportit në vitin 1945, Mark Gjon Marku kishte rreth vetes 30-40 persona kurse Muharrem Bajraktari 40-50 veta. Ata bënë mbledhje ku merrnin pjesë mbi 70-80 të arratisur të cilët merrnin vendime rreth organizimit dhe luftës që duhej ta bënin kundër pushtetit komunist. Sipas listës të grupeve të armatosura guerile në Shqipëri gjatë vitit 1945, hartuar nga Shtabi i Mbrojtjes Popullore të Shqipërisë ndër të tjera theksohet se Kolë Bibë Miraka dhe Pashuk Biba vërtitën nga Malësia e Madhe. Këto banda nuk u likujduan plotësisht. Ato vazhduan rezistencën të organizuara në grupe të vogla. Raporti pasqyron shifra të të arratisurve. Sipas tij deri në fund të nëntorit 1945 arrin numrin në 665 veta. Në muajin qershor korrik 1946 sipas të dhënave të sigurimit të shtetit shqiptar numri i të arratisurve kishte arritur në 672 persona, kurse në fund të muajit dhjetor 1946 në arrati ishin 459 persona. Rënia e këtij numri shpjegohet si shkak i vrasjeve, kapjes dhe dorëzimit të disa të arratisurish sidomos mbas amnistisë që ishte bërë.